



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KLOS  
KESHILLI KLOS

Klos më 11. 03.2024

**INFORMACION PËR VENDIMARRJEN DHE PUNËN E KËSHILLIT TË  
BASHKISË KLOS PËR VITIN 2023**

Të nderuar Këshilltare!

Këshilli i Bashkise Klos për vitin 2023 ka pasur një aktivitet të plotë në vendimarrje dhe në komunikim të vazhdueshëm me komunitetin. Edhe pse një vit elektoral kemi mundur të arrijmë disa objektiva madhore në kryerjen e funksioneve duke u mbështetur te ligji 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe legjislacioni sektorial per fusha të ndryshme të vetëqeverisjes vendore.

Duke qënë se Këshilli si organ i vetëqeverisjes vendore në zbatim të ligjit ka rol vendimarrës, përfaqësues dhe mbikqyrës/monitorues, jemi munduar të ushtrijmë këto role me angazhim dhe përkushtim.

Duke pasur parasysh se shumë aktivitete të zhvilluara bëjnë pjesë në më shumë se një nga rolet e mësipërme të Këshillit po mundohemi në mënyrë të përmbledhur të japim aktivitete kryesore të zhvilluara sipas kategorive.

Në lidhje me rolin vendimarrës, janë kryer kryesisht aktivitetet si më poshtë:  
Janë realizuar në total **14 mbledhje** të Keshillit, 12 prej tyre të radhës dhe **2** jashtë radhe me kerkesë të Kryetarit të Bashkisë;

Te gjitha bledhjet jane realizuar me takime fizike në sallë por duke marrë në konsideratë votat e këshilltarëve të shprehura nëpërmjet platformave online të Këshillit. Duhet theksuar që të gjitha mbledhjet e Këshillit janë zhvilluar në transmetim live nëpërmjet faqes së facebook, çka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjen madje të japë dhe mendimet dhe sygjerimet e tij për vendimet dhe çështjet që janë shqyrtuar;

Janë realizuar **7 mbledhje komisioni**;

Janë miratuar **87** vendime prej te cilave **2** të pa konfirmuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut Diber. Nga vendimet e pakonfirmuara **2** vendime janë konfirmuar nga prefekti pasi janë rifutur në këshill dhe janë miratuar me ndryshimet përkatëse.

Gjithashtu gjatë vitit 2023 kemi miratuar buxhetin e dedikuar vetëm për Këshillin me një fond prej 777. 200 lekë, i cili është ekzekutuar në masën 80 %

Për vitin 2024 objektivi ynë kryesor ishte implementimi i rregulloreve dhe planit të aktiviteteve në praktikë. Në bashkëpunim me këshilltarët, administratën dhe komunitetin kemi arritur zbatimin e planit të aktiviteteve në masën 90 %.

Në lidhje me rolin përfaqësues të këshillit për vitin 2023, faqja e Facebook-ut e Këshillit Bashkiak Klos e cila ka qene aktive që në vitin 2023, ka publikuar vazhdimisht aktivitet të këshillit, dhe realizuar transmetimin livestream të mbledhjeve, gje e cila, tashmë është pjesë e procedurave të zhvillimit të mbledhjeve. Ne faqen FB kanë ardhur shumë mendime dhe sygjerime nga komuniteti. Anëtarët e KB, janë fokusuar gjithashtu edhe në takimet direkte me banorët e Bashkiës Klos dhe përcjelljen e mendimeve të tyre në mbledhjet e komisioneve dhe të KB. Këshilli Bashkiak në bashkëpunim me Ekzekutivin ka kryer konsultime me komunitetin në lidhje me prioritetet e qytetarëve për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, konsultime të përbashkëta për PBA dhe projekt buxhetin, si dhe të gjithë dheniet e pronave publike në përdorim. Vetëm gjatë vitit 2023, Këshilli Bashkiak Klos bazuar në regjistrin e konsultimit, numeron 10 konsultime publike. Në zbatim të rregulloreve të miratuara është vënë në funksionim regjistri fizik i ankesave/kërkesave dhe një regjister fizik i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbëritura në drejtim të Këshillit të Bashkisë. Konkretisht janë depozituar në total 18 kërkesa të ardhura me protokoll. Janë trajtuar në të gjitha për të cilat janë marrë vendime dhe në bashkëpunim me Ekzekutivin është trajtuar 1 peticion dhe në të gjitha rastet janë informuar qytetarët. Gjithashtu Këshilli Bashkiak ka shqyrtuar edhe kërkesa të ardhura nëpërmjet këshilltarëve direkt në mbledhje të këshillit. Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përveç ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezazuara nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës me rastin e shqyrtimit të gjithë projekt-vendimeve të propozuara nga ekzekutivi, në zbatim të planit të aktiviteteve të vitit 2023 pothuajse në çdo mbledhje janë paraqitur drejtori të ndryshme për të raportuar në lidhje me analizën e sektorit të tyre para këshilltarëve sipas planit të punës të miratuar në fillim të vitit. Në këtë drejtim, edhe gjatë vitit 2024, do të vijojë një bashkëpunim edhe më i mirë me administratën dhe një angazhim më i madh për Ekzekutivin, për përgatitjen në kohë të raporteve dhe informacioneve të planifikuara në planin e aktiviteteve të këshillit por edhe rast pas rasti, sipas kërkesës së KB. Është punuar gjithashtu në drejtim të transparencës, dhe referuar web të Bashkisë, seksioni Këshilli bashkiak janë plotësuar të gjitha rubrikat me informacione të ndryshme të këshillit si vijon;

<https://bashkiaklos.gov.al/antaret-e-keshillit-bashkiak/>

<https://bashkiaklos.gov.al/komisionet-e-keshillit-2/>

<https://bashkiaklos.gov.al/projektvendimet/>

<https://bashkiaklos.gov.al/rregulloret-e-keshillit-bashkiak/>

<https://bashkiaklos.gov.al/dokumente-financiare/>

<https://bashkiaklos.gov.al/proces-verbalet-e-mbledhjes/>

<https://bashkiaklos.gov.al/regjistri-i-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak-bashkia-klos/>

<https://bashkiaklos.gov.al/regjistri-i-ankesave-kerkesave-dhe-verejtjeve-bashkia-klos/>

si dhe seksione te tjera me informacione ne seksionin e keshillit.

Nga sa më sipër, duke ju falënderuar secilin për kontributin dhe angazhimin, si dhe duke falenderuar projektin “Bashkitë Forta”, për bashkëpunimin dhe asistencën për aktivitetin e Këshillit të Bashkiës Klos, ju ftojme të bëheni pjesë, për përmirësimin e punës së keshillit nëpërmjet mendimeve dhe sugjerimeve tuaja.

Faleminderit!

**SEKRETARI  
ETMOND DEMIRI**

